

## Specifikimet teknike

Kompania kontraktuese e shërbimit do të kryejë të gjitha punët e zakonshme që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e sipërfaqeve të gjelberta.

Në thelb, ky shërbim konsiston në :

**“MIREMBAJTJEN E SIPERFAQEVE TE GJELBERTA, DUKE I BERE ATO SA ME ATRAKTIVE, GJITHNJË DUKE U MBESHTETUR MBI TRADITEN”.**

Këto ndërhyrje duhet të kryhen në përputhje me standardet teknike të treguara në këtë specifikim, si më poshtë:

### **A-Shërbimet bazë**

#### **1. Mirëmbajtja e Sipërfaqeve të gjelbra**

Lulishtet I kemi klasifikuar në **Tipin A** (intensive) me 41,451 m<sup>2</sup>, (përfshihen kopshtet dhe parqet urbane me sipërfaqe më të madhe se 5000 m<sup>2</sup>, të kushtëzuar nga presioni i lartë social i frekuentuesve). **Tipin B** (të rëndësishme) me sipërfaqe 26,684 m<sup>2</sup> (zona të gjelbra të lagjeve, rreth rrotullime dhe parqe lojrash. Dhe **Tipin C** (mirëmbajtje të lartë) me sipërfaqe 21,805 m<sup>2</sup> që kërkojnë mirëmbajtje të veçantë. Meqënëse në qytetin e Shkodrës pothuajse të gjitha sipërfaqet e gjelbra janë të rikonstruara dhe të plotësuara me të gjitha elementet (si drure dekorativ, shkurre dekorative, gardhe të gjelberta, bar natyral, lule, rruge e sheshe si dhe stola dekorativ) edhe në preventivin e hartuar për këtë zë janë trajtuar shërbimet e të gjithë elementeve.

**a-Mirëmbajtja e barit të kultivuar:** Do të realizohet krahas zërave të tjerë në kompleks. Punimet kryesore në mirëmbajtjen e barit janë: vaditja e barit në periudhën e verës, e cila do të realizohet nëpërmjet vaditjes me tuba, me sprucator dhe në ato vende ku mungon uji, vaditja do të realizohet me bot uji, me qëllimin kryesor që të mbulohen nevjat me ujë që ka bari i kultivuar. Vaditja është llogaritur të bëhet në varësi të mungesës së rreshjeve që nga fundi I Majit dhe deri në Tetor. Element I rëndësishëm është edhe kositja e sipërfaqeve të barit në të cilën kemi menduar të realizojmë 12 kositje. Kositja do të kryhet në fillim të muaji Prill deri në fund të muajit Tetor. Këtë proces do ta realizojmë me makina kositëse bari. Krahas saj në vende ku do të kemi dëmtime të sipërfaqes së barit do të bëjmë riparimin e tyre nëpërmjet mbjelljes me farë bari.

#### **b-Drurët dhe shkurret:**

Për drurët element I rëndësishëm është krasitja e tyre, që realizohet në periudhën Dhjetor – Shkurt, periudhë në të cilën drurët janë në qetësi relative. Janë të parashikuara dhe proceset e punimit të tokës përreth drurëve dhe eliminimit të barërave të qjija përreth tyre. Për shkurret dekorative është parashikuar gjithashtu krasitja e tyre duke I dhënë forma të ndryshme dekorative. Për shkurret gjetherënëse krasitja bëhet gjatë dimrit, ndërsa për ato gjethembajtëse krasitja bëhet edhe gjatë muajve të tjerë të vitit

#### **Llojet e pemëve dhe të shkurreve**

Pemët që do mbillen do të jenë disa tipesh, të cilat do të përcaktohen në numra dhe lloje në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë, duke i harmonizuar në plan-vendosje. Drurët dotë jenë të tipeve, **Likuidamos, Pisha, Ginko, Magnolia Santangeana.**

Edhe shkurret do të vendosen në bashkëpunim me specialistët e Bashkisë dhe do jenë disallogjesh. **Shkurret do të jenë, Kalistemum, Fotinja, Spirea, Oleander.**

Lulet te jenë sipas përcaktimeve nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

*c-Bordurat e gjelbra* janë parashikur të krasiten mesatarisht 1 herë në muaj (3 faqet) me qëllim mbajtjen e tyre në format e duhura dekorative. Po kështu edhe punimet e tokës përreth këtyre gardheve.

*d-Lulet sezonale në lulishte* janë një element i rëndësishëm. Gjatë vitit është parashikuar që parteret në lulishte të jenë me lule gjatë gjithë vitit. Theksojmë se përkëtë proces pune parashikohet mbjellja e fidanit të lules në lulishte dhe shërbimet në lule deri në marrjen e farës në lulishte. Llojet e luleve që do të përdorim janë: Viola pedunculata, Ciklamin, Taget, Salvia, lule Bora, Trëndafila etj.

## **2. Mirëmbajtja e gjelbrimit rrugor**

Drurët e gjelbrimit rrugor të qytetit të Shkodrës me një numër total të preventivuar prej 6641 rrënjësh i kemi klasifikuar sipas lartësisë në tre Tipe:

- Tipi 1 (lartësi deri në 5 m) me 3,250 copë
- Tipi 2 (lartësi 5 deri në 10 m) me 1,534 copë
- Tipi 3 (lartësi 10 deri në 15 m) me 2021 copë

Shërbimet kryesore në këto drurë dekorativ do të jenë krasitjet e përvitshme dhe punimet e tokës përreth drurëve me qëllim eliminimin e barërave.

## **3. Mirëmbajtja e sipërfaqeve ujore**

Në mirëmbajtjen e sipërfaqeve ujore (shatërvane) është llogaritur të kryhet pastrimi nga papastërtitë që krijohen në to, çdo muaj, pra 12 herë në vit, kjo për qytetin, ndërsa sipërfaqja ujore në plazhin e Velipojës do pastrohet 4 herë, vetëm gjatë sezonit.

Proçeset që do të kryhen do jenë që nga heqja e ujit të ndotur nga shatërvani, larja e sipërfaqeve të pllakave me fshesa dhe uje me presion duke përdorur detergjentë, largimi i mbeturinave nga sipërfaqet ujore si dhe vënia në punë e shatërvanit nga personi i specializuar.

Janë llogaritur edhe punimet që do të kryhen në mirëmbajtjen e elektromotoreve , sprucatorvesi dhe pompave (riparimin e tyre) për të qënë në gatishmëri të plotë.

## **4. Mirëmbajtja e shkurreve dekorative (Rr. M. Pashë Plaku)**

Do të shërbehet në krasitjen e shkurreve duke I dhënë formën e duhur dekorative, punimet e tokës përreth tyre për eliminimin e barërave të keqja. Me rëndësi do të jetë dhe vaditja gjatë periudhës së Verës dhe aty ku nuk kemi mundësi vaditje me tub uji do të përdorim botin e ujit për vaditje.

## **5. Mirembajtja e stolave dekorativ**

Meqenese në të gjithë sipërfaqet e gjelbra (lulishte) krahas elementeve bimor janë vendosur edhe stola dekorativ për çlodhjen e qytetarëve do të bëhet mirëmbajtja e tyre. Këto stola janë të ndërtuar me konstrukcion metalik apo kembe betony dhe me ndenjese e mbeshtetese druri. Është llogaritur që çdo vit të bëhet riparimi i tyre nga subjekti fitues. Riparimet bëhen kryesisht në elementet e drurit mbasi ka dëmtime të tyre dhe në kushtet atmosferike të keqja struktura e dërrasës ka nevojë për riparime dhe lyerje me bojë vaji. Do të mirëmbahen gjatë gjithë vitit 401 copë stola dekorativ.

## **6. F.V. fidana lule sezonale**

Për këtë zë janë parashikuar mbjellje të fidanave të luleve për tre sezone me tipologji lulesh tradicionale te qytetit , sipas kërkeses nga Autoriteti kontraktor Me këto fidanë parashikojmë të mbulojmë të gjitha nevojat me lule në lulishte gjatë gjithë vitit. Pra nje siperfaqe e organizuar per mbjellje lulesh , planifikohet te mbillet dy here ne vite.

## **7. Mbjellje drurë dekorativ (në lulishtë dhe gjelbrim rrugor)**

Në këtë zë janë parashikuar që te mbillen 40 copë ne vite drurë dekorativ në lulishte dhe gjelbrim rrugor, si zevendesim i atyre qe demtohen . Është planifikuar hapja e gropës transporti I dheut vegjetal dhe plehut që do përdoret për mbjellje, druri dekorativ, sipas kërkeses se autoritetit dhe vendosja e drurit mbajtes per ruajtjen e vertikalitetit dhe koshave mbrojtës.

## **8. Mbjellja shkurre dekorative**

Në këtë zë janë parashikuar të mbillen 100 copë shkurre dekorative ne vit. Është planifikuar hapja e gropës, transporti I dheut vegjetal dhe plehut që do përdoret për mbjellje.

## **9. Mbjellje bordurë e gjelbër**

Në këtë zë janë planifikuar 300 ml bordure ne vit. Është planifikuar hapja e kanalit dhe transporti i dheut vegjetal që do përdoret për mbjellje.

## **B-Standartet e fidaneve qe pranohen per mbjellje**

### **1. Drurë dekorativ**

#### **Kushte teknike te pergjithshme**

- Trupi i tyre duhet të jetë i drejtë dhe i padëmtuar.
- Kurora e fidanit duhet të jetë e zhvilluar mirë dhe duhet të ketë më shumë se tre degëzime.
- Nuk duhet të ketë degëzim të tharë.
- Sistemi rrënjor duhet të jetë i zhvilluar dhe i shëndetshëm.
- Ambalazhimi i rrënjëve duhet të jetë me qese me diameter 30-40cm dhe lartësi 60 cm, ose në vazo transpianuara qysh një vit me parë.
- Si trupi ashtu edhe degëzimet e fidanit duhet të jenë të pa infektuara dhe të padëmtuara nga insektet.
- Gjethet duhet të kenë ngjyrën karakteristike të kultivarit.

#### **Kushtet teknike të veçanta**

- Mosha e fidanit të drurit dekorativ duhet të jetë mbi 8 vjeç.
- Lartësia e fidanit pa sistem rrënjor duhet të jetë mbi 2.5 m.
- Diametri i qafës së rrënjës duhet të jetë jo më pak se 9 cm.
- Diametri i kërcellit në 1m lartesi 6-8 cm.
- Lartësia e sistemit rrënjor duhet të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kurorës së krasitur të jetë jo më pak se 50 cm.

## 2. Shkurret dekorative

### Kushte të përgjithshme

- Shkurret duhet të jenë me kërcell të rregullt me më shumë se 5 degëzime
- Me kurore të krasitur ose me forma pa dëmtime të bisqeve
- Pa degëza të thara
- Me sistem rrënjor të zhvilluar mirë dhe i shëndetshëm
- Rrënjët dhe degëzimet të painfektuara dhe pa dëmtime nga insektet.
- Ambalazhimi i sitemit rrënjor duhet të jetë me qeska qysh kohë më parë.

### Kushtet teknike të veçanta

- Mosha 4-5 vjecare
- Lartësia e fidanit pa sistem rrënjor duhet të jetë mbi 50 cm.
- Diametri i kurorës së krasitur të jetë mbi 40 cm.
- Diametri i kërcellit në rreth 2 cm.

### Kushtet teknike te fidaneve te luleve

- Fidanet e luleve duhet të jenë të zhvilluara në qeska të trajtuara me plehra dhe të kalitura në serë.
- Duhet të kenë një lartësi jo më pak se 15cm me kërcëll të shëndoshë,
- Të jetë me kurora të zhvilluara me më shumë se 3 bisqe, të çelura ose të paktën të gonxhuara.
- Mbjellja e fidaneve nëpër lulishtedo realizohet sipas njëprojekti të dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve, për të gjitha lulishtet ku do vendoset të mbillet.

## C-Mjetet dhe makineritë

Mjetet dhe makineritë që kërkohen për Shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbëra janë

Nr.	Mjete-Makineri	Copë
1	Makinë korrëse bari më gjerësi prerje jo më pak se 80cm 	1
2	Motokorrëse bari me rrota 	3

3	Freze per punim toke	1
<div data-bbox="406 126 787 472" data-label="Image"> <p data-bbox="600 136 787 178">Dredge machine</p> </div>		
4	Frez per copezim trng pemesh te prera ose te demtuara	1
<div data-bbox="406 546 787 903" data-label="Image"> </div>		
5	Motosharrë dore për krasitje bimesie e ulet	2
6	Motosharrë me krah për krasitje pemësh ne lartesi	2
7	Makinë transporti jo më pak se 1.5 ton ( per materiale dhe puntor)	1
8	Makinë transporti jo me pak 3-5 ton me sponda te larta, per evadimin e gjetheve dhe mbetjet e krasitjes	1
9	Mjet për krasitjen në lartësi, (me platformë, kosh etj.)	1
10	Gershera te madhesive te ndryshme	10
11	Ferlin për prerje bari dhe shkurresh	2
<div data-bbox="406 1312 828 1638" data-label="Image"> </div>		
12	<b>Depozite uji për vaditje jo me pak se 2.5 m<sup>3</sup></b>	<b>1</b>
13	Aspirator për pastrim gjethesh	1
<div data-bbox="406 1732 763 1995" data-label="Image"> </div> <div data-bbox="763 1732 1112 1995" data-label="Image"> </div>		

## D- Fuqia puntore

Për kryerjen e këtij shërbimi sipas standarteve kërkohen:

Nr.	Pozicioni	Persona	Detyrat-Përshkrimi
1	Specialist	1	Agronom
2	Specialist	1	Inxh. Pyjesh
3	Specialist	6	Punonjës të trajnuar për punime në kopshtari
4	Specialist	1	Punonjës i trajnuar për punime ne presencë uji (elektriçist për shatervanët)
5	Shofer	1	Sipas mjeteve
6	Manovrator	1	Sipas mjeteve
7	Specialist	1	Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë
8	Punëtor	13	Punonjës për punime sipas zërave të preventivit
	<b>TOTAL</b>	<b>25</b>	Punonjës.

## E-Siguria dhe uniforma ne pune.

Punonjesit e subjektit sipërmarres duhet:

- 1-Te jene te pajisur me veshje per pune ne sezonin e veres dhe ate te dimrit. Uniforma duhet te jete e identifikuar me emrin e subjektit sipërmarres.
- 2-Përkrenare mbrojtëse e kokës per aktivitetet që ju ruajne ndaj lëndimeve
- 3- Priza veshësh ose mbulesa veshi ne kushtet e përdorimit te makinerive ose pajisjeve te zhurmshme.
- 4- Syzet e fytyrës, mburojat e fytyrës per punë që ekspozon projeksionet, copëza dhe pluhurit,
- 5-Maska për fytyrën për rrugët e frymëmarrjes. Puna që ekspozon pluhurin, fibrat, tymi.
- 6- Doreza per pune që ju ekspozon ndaj prerjeve dhe gërvishtjeve, apo per pune që ju ekspozon ndaj djegieve ose lendeve kimike.
- 7- Këpucë sigurie për këmbë me majë çeliku, pllakë kundër shpimit dhe rezistente ndaj rrëshqitjes .
- 8- Rripin e sigurimit me pajisje frenuese, pajisje për ndalimin e rënies nga punimet ne lartesi.

## F-Penalitete

### *1-Uniformen e punonjesve dhe pajisjet personale mbrojtëse.*

**Penaliteti:** Per cdo punonjes pa uniforme 5,000 lek. Pas penalitetit , i jepet 10 dite afat operatorit per plotesim me uniforme, ne te kundert , ne mungese te realizimit cdo punonjes penalizohet me 50,000 lek.

### *2-Monitorimi nga operatori në lidhje me identifikimin e problematikave në pemët e larta që janë rrezik për sigurinë publike.*

*Penaliteti: Per cdo rast te evidentuar nga perfaqesuesi i autoriteti kontraktor, që nuk nderhyret ne kohe per te eliminuar rrezikun, penaliteti 50,000 lek.*

### *3-Dëmtim i bimeve, pemëve , shkurreve si pasojë e moskryerjes së shërbimit te mirembajtjes*

Penaliteti: Për çdo rast të tillë dëmtimi, penaliteti është në vlerë të plotë të rregullimit të demit (zevendesimit).

#### ***4- Depozitimi i mbetjeve te gjelberta .***

Operatori duhet qe te gjitha mbetjet e gjelberta ti trajtoje per kompostim ne vendin e tij te deklaruar, ne te kundert, hedhja e tyre ne pika te tjera penalizohet ne masen 50,000 lek per cdo rast te evidentuar.

#### ***5-Tabelat orientuese per sigurine e njerezve apo tabelat ndergjegjesuese.***

Mungesa e tabelave orientuese per sigurine e njerezve , gjate realizimit te sherbimit te mirembajtjes , apo mungesa e tabelave ndergjegjesuese ne siperfaqet e gjelberta te ruajten e tyre, per cdo rast te evidentuar operatori penalizohet ne masen 10,000 lek.

#### ***6-Mbjellja e pemeve sipas standarteve.***

Për të siguruar standartet ne procesin e mbjelljeve te pemeve, ato duhet te vendosen ne vertikalitet duke u perforcuar me shtylla mbështetëse në diametër dhe lartësi të përshtatshme për madhësinë pemeve.

Per mos-vendosje te shtyllave mbeshtetese, per te ruajtur vertikalitetin e pemeve, per cdo peme te evidentuar operatori penalizohet ne masen 10,000 lek .